

ALMIRA SADIKAJ

**MBIEMRAT E PËRBËRË E TË PËRNGJITUR NË POEZINË
E DRITËRO AGOLLIT**

Dritëro Agolli konsiderohet një prej shkrimtarëve më të rëndësishëm e më të spikatur të letërsisë shqipe, një poet prodhimtar e cilësor¹, autor i veprave të shumta të përfunduara e të pa plotësuar, si poet idealist, ëndërrimtar e shtegtar i përjetshëm. Ai renditet jo vetëm si njëri prej poetëve tanë më të mirë bashkëkohorë, por njëri prej poetëve tanë më të mirë të të gjitha kohërave. Për prof. Shaban Sinanin “Dritëro Agolli është figurë qendrore e poezisë shqipe në gjysmëshekullin e fundit”², një krijues i mirënjohur, i cili njeh arritje kulmore në të gjitha sferat e letërsisë artistike.

Gjatë studimit të veprës së D. Agollit, të tërheq vëmendjen jo vetëm ana e formës dhe e përmbajtjes, por edhe veçoritë e gjuhës popullore të dialektit të Devollit, për të cilën autori ka treguar kujdes duke shfaqur të gjitha elementet dhe mjetet që ndërtojnë një vepër artistike. Duke i marrë fjalët nga sfera të ndryshme të jetës e të mendimit ato dalin shumëkuptimëshe, kjo, për shkak të lidhjeve që krijojnë, duke u përdorur në kontekste të ndryshme. Por, përveç kësaj, gjuha e veprës së Agollit dallohet edhe për dendurinë e shprehjeve e njësive frazeologjike, si edhe për leksik të thjeshtë, me anë të së cilit autori pasqyron një pjesë të historisë, kulturës, traditës, gjuhës, letërsisë, jetës së fshatit të pas viteve '60, por dhe më pas. Agolli dallohet edhe për origjinalitetin e fjalëkrijimeve të reja të cilat i ka strukturuar sipas traditës etnografike devolliane, duke na i pasqyruar në vepër. Kështu, ka përdorur dendur dhe me një art të veçantë fjalët e prejardhura, fjalët e përbëra, shprehjet frazeologjike, neologjizmat, etj., duke plotësuar dhe zgjeruar fondin fjalëkrijues të tij, me anë të cilave na ka dëshmuar hershmërinë dhe dendurinë e tyre në të folmet shqipe. Përdorimi i dendur i fjalëve të përbëra ndodh, sepse kompozitat, duke pasur të paktën dy tema motivuese, kanë zakonisht një ngarkesë emocionale më të madhe se fjalët e prejardhura dhe e paraqesin më qartë e në mënyrë të drejtpërdrejtë nocionin që shprehin³, gjë, që na ka shtyrë të merremi konkretisht me këtë çështje.

Duke u mbështetur edhe në studimet e bëra për fjalëformimin dhe problemet e ndryshme që lidhen me të në gjuhën shqipe, pohojmë se, fjalëformimi duhet të studiohet mbi bazën e tri aspekteve kryesore: në aspektin morfologjik, semantik dhe sintaksor. Meqë fjala si njësi leksiko-gramatikore që përfaqëson unitetin e

¹ R. Zisi - L. Boçi, *Dritëro Agolli dhe letërsia shqipe*, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Dritëro Agolli, Personalitet i shquar i letërsisë dhe i kulturës shqiptare”, Gjirokastër, 2013, f. 17.

² Sh. Sinani, “*Njerëzit e krisur*” të Dritëro Agollit, Shtëpia Botuese “Naimi”, Tiranë, 2012, f. 16.

³ *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 70.

kuptimeve leksikore me tërësinë e formave dhe të kuptimeve gramatikore, në procesin e ligjërimit hyn në lidhje me fjalë të tjera dhe kryen një funksion të caktuar sintaksor, themi se: *në krijimin e një fjale të re nuk duhet të mbështetemi vetëm aspektin morfologjik e semantik, por duhen marrë parasysh edhe rrethanat sintaksore në të cilat lind ajo*. E parë në këtë pikë mund të pohojmë se: Shqipja standarde po njeh zhvillim të dukshëm në fushën e leksikut, ku hasim krijime të reja fjalësh, me futjen në përdorim të njësive nga dialektet e të folmet popullore. Formime të tilla i gjejmë jo vetëm në vepra letrare, poezi, prozë, etj., por edhe në publicistikë e përkthime, ku ndeshemi edhe me formime mbiemrash që nuk ndjekin asnjë ligjësi morfologjike a semantike. Fjalëkrijime të tilla i kemi hasur edhe në veprën e Agollit, ku dhe kemi zgjeruar studimin tonë për mbiemrat dhe formimin e tyre. Në “Gramatikën e gjuhës shqipe I” (botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë) shkruhet se: “*Mbiemër quhet ajo pjesë e ligjëratës që emërton një tipar (cilësi, veti, marrëdhënie) të sendit dhe përshtatet në gjini, në numër e për një pjesë edhe në rasë me emrin e këtij sendi*”⁴. Ndërsa për prof. Shaban Demiraj “Mbiemrat e shprehin përshtatjen e tyre me emrat në gjini, në numër dhe në rasë me anë të nyjave të përparme a me anë të mbaresave”⁵. Duke qenë se: Mbiemri është një nga klasat më të pasura leksiko-gramatikore të gjuhës shqipe, që paraqet një fushë të gjerë studimi për këdo, për gjuhëtarin, për mësuesin, për studiuesin e dashamirësin e gjuhës, etj., kemi menduar ta thellojmë studimin tonë rreth formimit të mbiemrave të përbërë e të përngjitur në poezitë e Agollit, kjo, dhe për faktin se, Dritëro Agolli hyn në grupin e shkrimtarëve me stil, prodhimtarë, por dhe të matur në ritmin e publikimeve⁶. Në poezitë e tij të bie në sy një numër i konsiderueshëm njësish leksikore, krijime të autorit, ndër të cilat vendin më të rëndësishëm e zënë mbiemrat e përbërë (kompozitat) dhe mbiemrat e përngjitur. Sipas A. Kostallari “*Fjalë e përbërë ose kompozitë*” e mirëfilltë në gjuhën shqipe është ajo fjalë dygjymtyrëshe që formohet nga bashkimi i dy a më shumë temave në një fjalë të vetme, në një njësi të vetme leksiko-semantike strukturalisht të mbyllur, ka kategoritë e veta fjalëformonjëse, zhvillohet semantikisht dhe kryen funksionet e veta gjithnjë si një tërësi-fjalë, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramatikore të komponentëve të saj.⁷ Dihet që klasa leksiko-gramatikore e mbiemrave në gjuhën shqipe është një nga klasat më të studiuar, por edhe me shumë dukuri interesante, që mund të lidhen me të gjitha rrafshet: *me rrafshin morfologjik, me rrafshin kuptimor, me rrafshin sintaksor, me rrafshin stilistikor, me rrafshin fjalëformues* etj. Në këtë pikë ne jemi marrë kryesisht me rrafshin fjalëformues duke bërë edhe klasifikimin e mbiemrave **sipas formimit të tyre**. Mënyrat më prodhimtare e fjalëformimit të mbiemrave janë disa: prejardhja ku përfshihen (nyjëzimi, ndajshëtimi, nyjëzimi dhe ndajshëtimi

⁴Gramatika e gjuhës shqipe I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 153.

⁵ Sh. Demiraj, Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe, Tiranë, 1972, f. 262.

⁶ R. Zisi, Antologji poetike për kuajt, Tiranë, 2014, f. 15.

⁷ A. Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, BUSHT, Tiranë, 1961, nr. 1, f. 12.

Mbiemrat e përbërë e të përngjitur në poezinë e Dritëro Agollit

njëkohësisht), konversioni, përbërja, paranyjëzimi dhe mënyra e përzier⁸. Për sa i përket ndarjes sipas fjalëformimit, mbiemrat e gjuhës shqipe ndahen në **mbiemra të parmë** dhe **jo të parmë**.

Mbiemrat e parmë janë ato mbiemra të cilët janë të paanalizueshëm në pjesët e tyre përbërëse, kurse **mbiemrat jo të parmë** janë ata, të cilëve mund t'u hetohet prejardhja nga një fjalë tjetër me pjesëmarrjen e morfemave të ndryshme fjalëformuese, ose me rrugë të tjera. Këtu dallohen: **mbiemrat e prejardhur** me parashtesim, prapashtesim, nyjëzim e prapashtesim njëkohësisht dhe nyjëzim, parashtesim e prapashtesim njëkohësisht, si dhe **kompozimin ose mbiemrat e përbërë** të cilët formohen nga bashkimi i dy a më shumë temave. Këta mbiemra ndahen në dy grupe: *mbiemra të përbërë me lidhje bashkërenditëse, dhe mbiemra të përbërë me lidhje nënrenditëse*⁹.

1. Klasifikimi i kompozitave mbiemërore (mbiemrave të përbërë)

Me anë të fjalëve të përbëra apo kompozitave trashëgoohen disa përbërës kuptimorë të njësisë a njësive të mëparshme, pavarësisht nëse ajo është një fjalë e re që shënon një nocion të ri dhe ka përbërësit e saj kuptimorë. Këto kompozita përbëjnë pjesën më të madhe të njësive leksikore të krijuara nga autori. Në krijimin e tyre autori ka përdorur mjete fjalëformuese të gjuhës shqipe, por dhe të huaja të cilat njihen si të tilla nga sistemi fjalëformues i gjuhës shqipe.

Gjatë studimit të poezisë së Agollit, vumë re se, autori spikat më tepër në krijimin e mbiemrave të përbërë me lidhje nënrenditëse. Kjo është një mënyrë fjalëformimi mjaft prodhimtare e mbiemrave në gjuhën shqipe. Veçori e këtij tipi fjalëformues është karakteri përcaktues i njërit prej elementeve të fjalës së përbërë. Njëri nga elementet, herë i pari e herë i dyti mund të jetë përcaktuesi. Si tema fjalëformuese që marrin pjesë në formimin e këtyre mbiemrave, dallojmë:

1) *Kompozita mbiemërore të përbërë nga dy tema emërore*. Këta mbiemra tiparin e emërtojnë nëpërmjet krahasimit të një pjese të sendit të karakterizuar me një send tjetër, duke i veshur të parës një nga tiparet dalluese të të dytë: *mjekërcjap* (që e ka mjekrën si cja, Fletorka e Mesnatës, f. 216), *vetullhënë*, *vetullngjalë*, *vetullathanë* (që e ka vetullën si thanë, Udhëtoj i menduar, f. 315), *qimekashte* (Dil, Bajram Trebinja, nga ahuret, Dil, Bajram Trebinja, qimekashte, Poezi, f. 359). Në poezitë e Agollit vërejmë edhe këtë tip fjalëformimi: *ku elementi i parë përcakton të dytin*. Edhe ky tip fjalëformimi është bërë më prodhimtarë në gjuhën shqipe, burimin e vet e ka në gjuhën popullore. Në veprën e Agollit janë të pakta rastet e përdorimit të këtij tipi fjalëformimi. Në këtë rast, elementi i parë, përcaktuesi, është një emër çfarëdo, kurse elementi i dytë i përcaktuari është një emër vepruesi. Tek kjo mënyrë po veçojmë rastin: *gjakdhënës* (dhënësi i gjakut).

⁸ *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 184.

⁹ *Shënim*. Për të bërë klasifikimin e mbiemrave të përbërë dhe të përngjitur jemi mbështetur në kapitullin rreth mbiemrave në "*Gramatika e gjuhës shqipe I*", Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002.

2. *Kompozita mbiemërore të përbëra nga një temë emërore dhe një temë mbiemërore.* Një studim të hollësishëm për këtë tip fjalëformimi ka bërë gjuhëtari A. Kostallari¹⁰. Ndërsa në “Gramatika e gjuhës shqipe I” thuhet se: “Në këto kompozita si element përcaktues shërben elementi i dytë, pra tema mbiemërore, ndërsa elementi i parë është një emër çfarëdo që emërton një pjesë ose diçka që i takon sendit të karakterizuar nga mbiemri i përbërë¹¹. Ky tip është nga më prodhimtarët edhe në poezinë e Agollit. Karakteristikë e këtyre kompozitave është se, në themel të tyre qëndron mbiemri cilësor, më tepër shënojnë tipare të jashtme fizike dhe më pak cilësi të tjera, p.sh.: *gushëbardhë, qimebardhë, shtatlartë* (Dhe nuk e di e lumtur është vallë, Me burrin zemërbardhë e shtatlartë, Poezi, f. 86), *shamihollë, vetullahollë* (Mes dy malesh me dëborë, Ra një trim vetullahollë, Poezi, f. 572), *fytyrëkuq e flokërrallë* (Poezi, f. 66), *festebardhë, flokëbardhë, flokëverdhë, jelekartë* (Poezi, f. 587) *faqeftohtë* (Shek, f. 538), *zemërmirë* (Poezi, f. 524), *sykaltër* (Poezi, f. 58), *shtatlartë* (Fjala gdhend gurin, f. 127), *zhurmëmadh, murelartë* (Në pallatin murelartë, Murezbardhurin si kartë, Lypësi i kohës, f. 47), *bojëgjelbër, pallëthyer, mustaqeverdhë* (Lutjet e Kambanës, f. 128, 129, 133, 134), *pendëkaltër, dyfeklarë* (Dhe heronj dyfeklarë, Këtu çapiteshin, Poezi, f. 99), etj. Një pjesë e këtyre mbiemrave që kanë si përbërës të parë emra që shënojnë pjesë të organizmit të njeriut, shpeshherë dalin edhe me kuptim të figurshëm metaforik, p.sh.: *brihollë, mendjelartë, mendjehollë, zemërbardhë* (Pelegriini, f. 195), etj.

3. *Kompozita mbiemërore të përbëra nga dy tema mbiemërore.* Ky tip fjalëformimi është shumë pak prodhimtar dhe mendohet se është rezultat i ndikimeve nga gjuhët e huaja. Në këtë tip mbiemrash elementi i parë përcaktohet nga i dyti, duke u saktësuar e duke u ngushtuar më tej, p.sh.: *termobërthamor* (Biri yt di të hyj në laboratorin *termobërthamor*, Siç hyn në arën ku zgjatin mustaqet misrta... Poezi, f. 567), Zanozja lidhëse *o* te ky tip fjalëformimi bën që të dy mbiemrat të shkrihen në një fjalë të vetme e të pazbërthyeshme.

4. *Kompozita mbiemërore të përbëra nga një temë ndajfoljore dhe një emër ose anasjelltas.* Ky tip është më pak prodhimtar dhe jo aq popullor. Ne kemi hasur në poezi më tepër ndërtimet e tipit *emër+ndajfolje*. Si temë fjalëformuese te këto kompozita shërben një emër çfarëdo i përcaktuar nga një ndajfolje. Tema emërore është gjithmonë një pjesë e sendit të karakterizuar nga mbiemri i dhënë, kurse elementi i dytë, ndajfolja, është edhe këtu elementi përcaktues i saj: *këmishjashtë* (Poezi, f. 58), *këmbëshpejtë* (Kënga e gëzimeve dhe e brengave, f. 171), *kryepërpyjetë* (Poezi, f. 384), etj.

5. *Kompozita mbiemërore të përbëra nga një numëror (a përemër i pacaktuar që tregon sasi) dhe një mbiemër.* Si tema fjalëformuese për këtë tip fjalëformimi në lidhje nënrenditëse shërbejnë një numëror çfarëdo ose përemrat e pacaktuar

¹⁰ A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972, f. 75-94.

¹¹ *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 199.

Mbiemrat e përbërë e të përngjitur në poezinë e Dritëro Agollit

shumë, disa, si element përcaktues, dhe një mbiemër çfarëdo, si i përcaktuar: *tridhjetëvjeçar*.

6. *Kompozita mbiemërore të përbëra nga një emër + mbiemër prejpjesor ose pjesore*. Karakteristikë të ky grup mbiemrash është se: tradita paraqitet mjaft e ruajtur - si gjymtyrë e parë vijon të dalë shpesh emërtimi i një pjese, i një organi të trupit të njeriut ose, më përgjithësisht, i trupit të një qenieje të gjallë¹², kështu kemi: *ballëlëruar, pendëshkruar* (Udhëtoj i menduar, f. 218, f. 300), *pendëkaltër*, (Kambana e largët, f. 81), *bishtlëpirë*, (Shek. 536), *hardhingrënë* (Mesditë, f. 114), *qimezgjidhur, kapeleshpuar, këmbëzbathur, kokëkrisur* (Poezi, f. 364), *ballëvrenjtur, krahëshkruar, krifarënë* (Dhe dimri krifarënë largohet i mërzhit, Si ai poeti që humb talentin e s'i shkruajnë më artikuj lavdërimi, (Lutjet e Kambanës, f. 227, Poezi, f. 292), festezbardhur, *xhufkëpërdredhur* (Po sipër ç'të kishin hedhur?, - Një jorgan xhufkëpërdredhur, Lypësi i kohës, f. 47), *mendjendritur*, etj. Në ligjërimin poetik agollian këto kompozita dalin si pronësore dhe kanë mundësi integruese në sistemin figurativ ligjërimor. Kompozitat pronësore A. Kostallari i klasifikon në dy grupe themelore. Në mbiemrat e leksikut poetik gojor dhe në mbiemrat e leksikut poetik letrar, duke vënë në dukje edhe marrëdhëniet që ekzistojnë mes këtyre grupeve. Për grupin e parë, ai thekson se, duke u lidhur me leksikun libror e duke u përvetësuar aktivisht nga poetët, ato "i japin vargut një kolorit popullor"¹³. Të tillë janë: *buzëplasur* (Lutjet e Kambanës, f. 172), *mjekërbardhë* (Lutjet e Kambanës, f. 224) *krahëgjatë, shtatlartë* (Një pishë e shtrembër në përrua, I tha një pishe krahëgjatë, -Sa keq, moj motër, më vjen mua, Je kaq e bukur, kaq shtatlartë!, Poezi, f. 445), *gjunjëprerë* (Poezi, f. 360), *qerpiknxirë* (Kambana e largët, f. 185), *hundëgjatë, leshgjatë* (Kambana e largët, f. 148), *qimekashtë, fytyrëflakë, shpirtpastër, vetullzezë, fatkeq* (Kam shumë punë para nisjes, kam shumë, Sa e shpëtova kaprollin fatkeq nga gjahtari, f. 56), *strehëgrisur* (Mesditë, f. 97), etj., të cilat dallohen për ngarkesë të veçantë emocionale. Po kështu A. Vehbiu dallon edhe një tip tjetër kompozitash, ato përcaktore. Një karakteristikë e rëndësishme e saj është se në të "ajo që shprehet nga gjymtyra përmbyllëse, përcaktohet më nga afër nga gjymtyra e përparme"¹⁴, si p.sh.: *kallirënduar, hardhimbuluar* (Poezi, f. 66). Pra në këtë drejtim themi se, përdorimi i këtyre njësive të reja fjalëformuese nga Agolli i shton koloritin bisedor ligjërimin agollian. Në fjalëkrijimet e përmendura nuk mungojnë edhe kompozitat dëshirore, të ndërtuara sipas psikologjisë popullore si: *buzëplasur* (Dhe ngremë kokën të menduar, Tek shohim çerdhet buzëplasur, Poezi, f. 403), *buzëplasur* (Fjala gdhend gurin, f. 71), *krahëthyer* (Unë qaj, kur shoh në bar një zog, Krahëthyer që nuk fluturon, Poezi, f. 181), *kryelartë* (Udhëtoj i menduar, f. 66),

¹² A. Vehbiu, *Vëzhgime për disa kompozita pronësore në poezinë e sotme shqiptare*, SF, nr. 1, Tiranë, 1987, f. 124.

¹³ A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, "Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", Tiranë, 1972, f. 118.

¹⁴ A. Vehbiu, *Një tip i veçantë kompozitash përcaktore të leksikut poetik të shqipes*, SF, nr. 1, Tiranë, 1991, f. 91.

ballukengatërruar (Shtigje dhe trotuare, f. 115). Gjatë punës tonë vëmë re se, një pjesë e kompozitave kanë marrëdhënie metaforike mes njësive ndërtimore, kështu dhe fjala e re ka kryesisht kuptim të figurshëm, gjë të cilën e shohim në ndërtimin e neologjizmave nga autori, të tilla janë: *moralhumbur*, *krifarënë*, *qepallgjelbër* (Re në krah në shkrep të vjetër, Re në krah e s'lojte dot, Pishë e re qepallgjelbër, Nga qepalla derdhi lot, Shtigje dhe trotuare, f. 72), *vetullngrysur* (Shtigje dhe trotuare, f. 82), *mendjendritur* (Shtigje dhe trotuare, f. 82), etj., njësi të cilat kanë hyrë në marrëdhënie me njëra tjetrën dhe jo me kuptimet e tyre të para.

2. Mbiemrat me përngjitje

Në trajtimin e fjalëformimit të dhe të përbërjes strukturore të fjalës nëpër gramatikën e shqipes, por edhe në studimet e ndryshme, nuk është arritur ende një përkufizim i saktë. Për këtë problem përdoren terma të ndryshëm, si: *fjalë e parme*, *a fjalë e parë ose fjalë e thjeshtë*, *kompozitë dhe fjalë e përbërë*, *por ndonjëherë kompozitat merren si një klasë e gjerë dhe ndahen në fjalë të përbëra dhe në fjalë të përngjitura*. Përngjitja, si mënyrë fjalëformimi, është studiuar edhe më parë në gjuhësinë shqiptare. Përsa i përket vendit dhe rolit të përngjitjes te mbiemrat mund të themi se: *në gjuhën e sotme shqipe kemi gjetur shumë pak mbiemra të formuar nëpërmjet përngjitjes të cilët janë kryesisht të ligjëritimit libror*. Megjithatë, ndonjë prej tyre përdoret në shqipen standarde si p.sh., mbiemrat: *bardheblu*, *bardhezi*, *foleqesh*, *gushëpëllumbi*, *kuqezi*, *(lule) mosmëprek*, *ndihmozot*, *mosozot*, *ngjyrëvishnje*, *bojëbari* etj.¹⁵ Numri i kufizuar i mbiemrave të përngjitur, krahasuar me numrin e madh të mbiemrave jo të parmë, provon se mbiemrat jo të parmë formohen kryesisht sipas modeleve të hapura fjalëformuese, kurse formimi me anë të përngjitjes përbën një përjashtim për këtë klasë mbiemrash.

Formimi i mbiemrave në gjuhën shqipe është trajtuar jo vetëm nëpër gramatikën, por edhe në artikuj të ndryshëm.

1. Mbiemrat e përngjitur janë rezultat i leksikalizimit dhe i përngjitjes së njësive:

a) Sintagmë me nënrenditje: *gushëpëllumbi*.

b) Sintagmë me bashkërenditje: *bardhezi*, *foleqesh*.

Vështirësi paraqet përngjitja si mënyrë fjalëformimi brenda së njëjtës gramatikë për shkak të lidhjeve të saj me prejardhjen dhe kompozimin, lidhur kjo me faktin se mbiemrat e përbërë nuk dallohen nga mbiemrat e përngjitur, por ata përfshihen në të njëjtën mënyrë fjalëformimi. Interes të veçantë paraqet roli i përngjitjes dhe lidhjet e saj me kompozimin e prejardhjen te mbiemrat.

2. Njësitë përbërëse të mbiemrave të përngjitur janë fjalë që u përkasin si pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës ashtu edhe pjesëve të pa ndryshueshme.

Me pjesë të ndryshueshme të ligjëratës kuptojmë kur ajo përbëhet nga:

a) sintagmë emërore e tipit emër + emër në rrjedhore: *gushëpëllumbi* → *gushë* + *pëllumbi*. Ky tip fjalëformimi në poezitë e Agollit del i ndarë, ndërsa nga studimet e bëra për formimin e mbiemrave të sotëm të përngjitur në gjuhën shqipe vëmë re, se lokucioni emëror “*gushë pëllumbi*” tashmë është shkrirë në një fjalë të

¹⁵ L. Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 149-159.

Mbiemrat e përbërë e të përngjitur në poezinë e Dritëro Agollit

vetme, pra: *gushëpëllumbi*. Po kështu ndodh edhe me: *ngjyrëvishnje* → *ngjyrë vishnje*. Përsa i përket anës strukturore: mbiemrat e përngjitur ndahen në: **a)** mbiemra të përngjitur që kanë në përbërjen e tyre vetëm morfema rrënjore, si: *mosprek, foleqesh, bardhezi*. **b)** mbiemra të përngjitur që kanë në përbërjen e tyre morfema rrënjore dhe morfema ndajshesore të eptimit: *gushëpëllumb-i, ngjyrëvishnj-e*. Kategoritë gramatikore të mbiemrave të përngjitur nuk mund të shprehen me mjete morfologjike. Një nga mjetet që mungon te mbiemrat e përngjitur është *nyja* e cila bën që mbiemrat e përngjitur të jenë të panyjshëm, dhe si të tillë ata nuk mund të përshtaten në gjini, numër dhe në rasë vetëm nëpërmjet nyjës së përparme. Po kështu edhe *prania e zanoreve fundore*, dikur tregues rasorë nuk shërben si tregues gjinie (ngjyrë *gushëpëllumbi*, fustan / kostum *ngjyrëvishnje*).¹⁶ Në poezinë e Agollit raste të tilla, ku hasim praninë e zanores fundore-e, janë të pakta, kështu kemi: *symanushaq-e* (Pa eja tek unë, o qengji symanushaqe, Afromi buzët e tua që vijnë erë qumësht e bar (Kambana e Largët, f. 17). Por ka edhe raste të kalimit të mbiemrave të përngjitur në mbiemra të përbërë raste të tilla janë të pakta në krijimtarinë agolliane: *shtatëcepësh* (Dhe mbi honin një hark *shtatëcepësh*, Ngrihet heshtur dhe zë ylberon, Vjen njeriu i çuditshëm, f. 183). Ky tip mbiemrash formohen nga përngjitja e përbërësve të sintagmave emërore të tipit *numërorë a përemër i pacaktuar + emër në rrjedhoren e pashquar shumë + prapashtesën-sh*, e cila konsiderohet si prapashtesë fjalëformuese në studimet e sotme mbi fjalëformimin.

Duke studiuar përbërjen dhe përngjitjen në përgjithësi, mund të themi se, vepra e Dritëro Agollit, ka vlera të mëdha jo vetëm letrare e artistike, por dhe vlera të veçanta gjuhësore. Tek ai dallojmë jo vetëm mjeshtrin në krijimin e njësisve të reja leksikore, por edhe shkrimtarin më të dashur për lexuesit mbarëkombëtar. Me anë të krijimeve të reja Agolli pasuron më tej leksikun potencial, që është një burim i përhershëm i zhvillimit dhe pasurimit të fondit leksikor të gjuhës letrare shqipe. Nëpërmjet vëmendjes që iu jep fjalëkrijimeve origjinale, ai shfrytëzon si modelet e vjela nga gurra popullore, po ashtu dhe mjetet që i ofron gjuha kombëtare. Si përfundim, mund të themi se Dritëro Agolli është një krijues shumë prodhimtar jo vetëm i letërsisë artistike, por dhe njohës i shprehjes gjuhësore. Vepra e tij ka vlera të mëdha studimore jo vetëm në fushë të letërsisë por dhe në fushë të gjuhësisë.

BIBLIOGRAFI

- A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972.
A. Kostallari, *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, “Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë, 1972.
A. Vehbiu, *Një tip i veçantë kompozitash përcaktore të leksikut poetik të shqipes*, SF, nr. 1, Tiranë, 1991.

¹⁶ L. Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009, f. 149-159.

A. Vehbiu, *Vëzhgime për disa kompozita pronësore në poezinë e sotme shqiptare*, SF, nr. 1, Tiranë, 1987.

Gramatika e gjuhës shqipe I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002.

L. Buxheli, *Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, Tiranë 2009.

R Zisi - L. Boçi, *Dritëro Agolli dhe letërsia shqipe*, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare” Dritëro Agolli, Personalitet i shquar i letërsisë dhe i kulturës shqiptare”, Gjirokastër, 2013, f. 17.

R. Zisi, *Antologji poetike për kuajt*, Tiranë, 2014.

Sh. Demiraj, *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972.

Sh. Sinani, *“Njerëzit e krisur” të Dritëro Agollit*, Shtëpia Botuese “Naimi”, Tiranë, 2012.

Vepra të vjela

D. Agolli, *Shtigje dhe trotuare*, Poezi, Shtëpia Botuese “Dritëro”, Tiranë, 1998.

D. Agolli, *Lypësi i Kohës*, Poezi, Shtëpia Botuese Enciklopedike, Tiranë, 1995.

D. Agolli, *Fletorka e Mesnatës*, Poezi, Shtëpia Botuese “Dritëro”, Tiranë, 1998.

D. Agolli, *Vëllim “Poezi”* Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1979.

D. Agolli, *Fjala gdhend gurin*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1977.

D. Agolli, *Lutjet e kambanës*, Botimet Toena, Tiranë, 1998.

D. Agolli, *Kambana e largët*, Shtëpia Botuese “Dritëro”, Tiranë, 1998.

D. Agolli, *Vjen njeriu i çuditshëm*, Shtëpia Botuese “Dritëro”, Tiranë, 1996.